



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.E.nr.22/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Zenel Leku dhe Nenad Laziq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Republika e Kosovës – Qeveria – Ministria e Infrastrukturës, të cilin e përfaqëson Avokatura Shtetërore, Prishtinë, kundër të paditurit Kompania “AL – P.” SH.P.K., me seli në ..., F. K., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas revizionit të paditësit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.504/23 datë 3.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24.05. 2024, mori këtë,

A K T V E N D I M

HEDHET si i palejuar revizioni i paditësit Republika e Kosovës, Qeveria –Ministria e Infrastrukturës, të cilin e përfaqëson Avokatura Shtetërore, Prishtinë, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.504/23 datë 3.07.2023.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, K.DH.SH.II.nr.504/23 të dt.3.07.2023, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar Aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë KE.nr.104/22

dt.17.01.2023, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, konsiderohet se është tërhequr padia me numër KE.nr.104/22 (C.nr.1470/17) e datës 9.06.2017, e paditësit Republika e Kosovës – Qevria – Ministria e Infrastrukturës, kundër të paditurit Kompania “AL P.” SH.P.K. – F. K., për kompensimin e dëmit (në vlerë prej 28,429.16 euro) dhe me pjesën e II të dispozitivit të tij, shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni i paditësit në tërësi si i bazuar.

Përgjigje në revizion ka paraqitur pala e paditur nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që i njëjti të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktvendimit të goditur dhe shkresave të lëndës si dhe lejueshmërisë së paraqitjes së revizionit sipas nenit 218 par.2 pika d) lidhur me nenin 14 par.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i palejuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se vlera e kontestit në padinë e paditësit, kundër të paditurit, të paraqitur më dt.9.06.2017, është 28,429.16 euro. Ndërkohë që me dispozitën e nenit 14.1 të ligjit për Gjykatën Komerciale, është përcaktuar që “ lidhur me kërkesat për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve përfundimtare të Gjykatës Komerciale të Republikës së Kosovës zbatohen ligjet procedurale në fuqi ”. Me par.2 të këtij neni përcaktohet që ” Përjashtimisht nga par. 1 i këtij neni, revizioni lejohet në kontestet me kusht që vlera e kontestit të jetë jo më pak se 30.000-euro”.

Sipas kësaj dispozite ligjore rrjedh se në rastin konkret, e duke qenë se vlera e kontestit është në shumë prej 28,429.16 euro, sikundër është cekur në padi, nuk kalon shumë e paraparë me dispozitën e sipër përmendur ligjore, që d.m.th. nuk kalon shumë prej 30.000-euro, revizioni në këtë çështje civile nuk është i lejuar.

Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218.1 dhe 2 pika d) të LPK-së, që të hedh revizionin e palejuar, Gjkata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u dashtë që të njëjtin ta hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221 lidhur me nenin 218, të LPK-ës, nenin 14.2 të Ligjit për gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.E.nr.22/2024 datë 24.05. 2024

Kryetari i kolegjit,
Mr.sc.Muhamet Rexha

